



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës së vlerësimit të veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braho dhe Tom Doshi

Mungojnë:

Damian Gjiknuri, Spartak Braho, Alban Zeneli dhe Elda Hoti

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Kourumi është i pranishëm.

Sot në rendin e ditës kemi një çështje: “Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018”. Jemi komision përgjegjës. Relator i kësaj projektrezolute është kolegu Adnor Shameti.

Zoti Shameti, keni fjalën.

Adnor Shameti – Faleminderit!

Unë do të ndalem te gjetjet dhe rekomandimet e Kuvendit në atë se çfarë duhet të përmirësojë institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, të cilat do t’jua rendis përmbledhtas.

Avokati i Popullit duhet të vazhdojë të ketë në vëmendjen e tij për vitin 2019 minimizimin e ankesave, të cilat janë jashtë sferës së veprimtarisë së tij duke rritur më tej aktivitetin e tij informues.

Avokati i Popullit duhet të rrisë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në njësitë ekstraterritoriale, ku zbatohet legjislacioni shqiptar dhe konkretisht problematikat që shtetasit shqiptarë hasin në shërbimet që marrin nga njësitë konsullore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Avokati i Popullit duhet të bëjë publikimin e rekomandimeve dhe çështjeve të zgjidhura në funksion të transparencës dhe informimit, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

Avokati i Popullit duhet të vijojë me ndjekjen rast pas rasti të çështjeve lidhur me rekomandimet e refuzuara ose të papërmbushura sipas procedurave të nenit 23 të ligjit nr.8454 të datës 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Për çështjet hetimore të raportuara, edhe në praktikën e trajtimeve të mëtejshme të vijohet me referime konkrete sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.

Avokati i Popullit duhet të krijojë dhe të bëjë publike një regjistër me ankesat/kërkesat e marra nga institucioni, si edhe të deklarojë statusin e tyre në kuadër të transparencës dhe të

njohjes së gjerë të publikut me çështjet e trajtuara nga institucioni, vërejtje kjo e dalë edhe gjatë seancës dëgjimore me Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit duhet të rrisë angazhimin në ndjekje të përmbushjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm “Akhenda 2013” me fokus të veçantë buxhetimin gjinor, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e konsumatorëve, detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushat përkatëse, si edhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Mbetemi të hapur që të gjitha rekomandimet e Komisionit të Ligjeve të gjejnë pasqyrim në variantin përfundimtar që do t’i shkojë Kuvendit për miratim në seancën e ditës së enjte.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Shameti!

Zoti Alimadhi ka kërkuar fjalën.

Adriatik Alimadhi – Në lidhje me pikën e parë, ku thuhet se Avokati i Popullit duhet të vazhdojë të ketë vëmendjen e tij për vitin 2019 në minimizimin e ankesave, ne nuk mund t’i themi avokatit t’i minimizojë, ai mund t’i zgjidhë ato. Pra, duhet një artikulum tjetër.

Ulsi Manja – Edhe jashtë sferës, nuk është në dorën e Avokatit të Popullit t’i minimizojë kërkesat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, kjo pikë e rezolutës ka lidhje me rritjen e rolit të Avokatit të Popullit në drejtim të informimit, por, gjithsesi, “informimi” duhet të dalë në fillim të fjalisë.

Vailika Hysi – Në fakt, ne e ndoqëm me vëmendje raportimin e Avokatit të Popullit, por njëkohësisht patëm një sërë pyetjesh dhe adresuam një sërë shqetësimesh lidhur me fushën e veprimtarisë së tij edhe me vëmendjen që duhet të tregojë për vitin 2019.

Së pari, kam një koment nga ana formale për rezolutën lidhur me gjuhën e përdorur në pjesën e vlerësimit të veprimtarisë së Avokatit të Popullit dhe, së dyti, në pjesën e rekomandimeve të tij.

Mendoj se projektrezoluta duhet rishkruar. Kur ne bëjmë vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, e vlerësojmë atë për treguesit që ka arritur, por jo për fushat e veprimtarisë së tij, sepse ato janë fusha.

Së pari: thuhet: “Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2018 lidhur me monitorimin e respektimit të të drejtave.” Por këtë e ka për detyrë. Unë mendoj se duhet thënë me rritjen e numrit, me rritjen e vëmendjes për respektimin e të drejtave të grupeve të veçanta të marginalizuara si fëmijët, të huajt e të tjerë.

Së dyti, thuhet: “Vlerëson dhënien e kontributit në mënyrë proaktive për përmirësimin e legjislacionit”. Pa dyshim, vlerësojmë kontributin në përmirësimin e legjislacionit dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit. Do të themi se kaq rekomandime e ka përmbushur, këto nuk i ka përmbushur, pra duhet të ketë disa tregues.

Për rritjen e numrit të çështjeve të iniciuara kryesisht dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet partnere duhet të themi: “Për rritjen e bashkëpunimit, forcimi dhe rritja e bashkëpunimit”, sepse ka tre elemente. Bashkëpunimi ka qenë historikisht, nuk është dhe as nuk do të jetë avokatja e fundit, por rëndësishme është nëse e ka zgjeruar bashkëpunimin, e ka rritur cilësisht apo e ka forcuar brenda atyre institucioneve me të cilat bashkëpunon.

Për pikën tjetër në të cilën thuhet: “Vlerëson funksionimin si mekanizëm për parandalimin e torturës... (fjalë më pas nuk lexohet shqip) i ka kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit dhe respektimit të të drejtave të personave”. Këtë pa dyshim e ka pjesë të kompetencave, si dhe duhet thënë: “Rritjes së vëmendjes së mekanizmit në adresimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në komisaritet e policisë, në institucionet e ekzekutimit”. Për këto terma ka gjuhë zyrtare juridike dhe nuk thuhet “vende e popuj”.

Tjetër, përballimi i volumit të rritur të ankesave dhe kërkesave. Nuk duhet thënë në këtë mënyrë, por trajtimi nuk është thjesht volumi, por ka të bëjë me cilësinë e trajtimit. Unë mund ta marr ankesën, por e rëndësishme është mënyra se si e trajtoj dhe nëse i jap zgjidhje i adresoj problemet.

Gjithashtu, në pjesën ku thuhet: “E vlerësojmë lidhur me realizimin e një numri të konsiderueshëm inspektimesh”. Kjo nuk duhet të jetë kështu. Pra, me inspektimet e kryera dhe me produktin që kanë pasur a ka pasur përmirësime? Duhet të jetë në mënyrë tjetër, me inspektimet e kryera dhe produktin që kanë. A kanë pasur produkt? A ka përmirësime? A kanë rekomanduar diçka?

E njëjta gjë është edhe për inspektimet në kuadër të torturës. Tortura nuk inspektohet, por monitorohet respektimi i të drejtave të shtetasve për parandalimin e torturës dhe të trajtimeve çnjerëzore e të tjera. Pra, nuk mund të thuhet “Inspektimet në kuadër të dhunës”.

Sa i takon pjesës së dytë, mendoj që rekomandimet duhet të jenë më konkrete.

E para, këtu pajtohem me propozimin e kolegut Alimadhi, Avokati i Popullit duhet të vazhdojë të ketë në vëmendjen të tij minimizimin e ankesave. Jo, sepse detyra e Avokatit të Popullit është të rrisë veprimtarinë e tij informuese dhe sensibilizuese lidhur me fushën e

veprimtarisë së tij dhe për rolin e tij. Nuk mund t'u thuash qytetarëve: Mos hajde këtu tek unë, sepse ai të do dhe atë beson.

E dyta, fjala “Avokat i Popullit” duhet të hiqet, sepse është vënë më lart, por nuk jam duke i hyrë teknikës legislative, pasi duhet rishikuar totalisht nga fillimi. Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit të rrisë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë. Nuk mund të thuhet në këtë mënyrë, por kështu: “Ne i kërkojmë Avokatit të Popullit të përmirësojë, sepse më lart thuhet “të përmirësojë punën”, ndërsa më poshtë “të rrisë angazhimin”, sepse foljet e përdorura në tekst janë të ndryshme.

Duhet të thuhet në këtë mënyrë: ta përmirësojë punën e tij apo ta rrisë, por kjo varet. Ai mund të ketë nevojë ta përmirësojë punën në disa aspekte, në disa aspekte të tjera mund të ketë nevojë që ta zgjerojë, ta forcojë punën e tij e kështu me radhë. Avokati i Popullit duhet ta rrisë angazhimin e tij për mbrojtjen e shtetasve shqiptarë jashtë territorit, duke rritur bashkëpunimin me organizatat homologe. Avokati i Popullit, të nderuar kolegë, nuk mund të punojë në Greqi, sepse çdo institucion kompetencat e tij, ashtu edhe Avokati i Popullit, i ka brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por ai bashkëpunon me organizatat homologe të tij ose adreson shqetësime.

Pika e tretë. Avokati duhet të bëjë publikimin e rekomandimeve, ndërsa këtu thuhet të përmirësojë punën dhe më pas të bëjë publikimin. Jo! Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Avokati i Popullit të publikojë rekomandimet e tij dhe t'i adresojë ato pranë institucioneve përgjegjëse dhe Kuvendit të Shqipërisë në kohë dhe ta informojë Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë e zbatimit të tij. Ky është mekanizmi, sepse publikimi i rekomandimeve është pjesë e ligjit, por problemi është që të na sensibilizojë ne, të na ndjekë dhe të na informojë në kohë, jo thjesht Shërbimet e Monitorimit, por këtu ka një komision, të cilit duhet t'i adresohen.

Pika e katërt. Avokati duhet të vijojë me ndjekjen rast pas rasti të çështjeve lidhur me rekomandimet e refuzuara. Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit të ndjekë shkallën e zbatimit të rekomandimeve të tij, arsyet përse rekomandimet nuk janë përmbushur ose nuk janë pranuar dhe të informojë institucionet përgjegjëse dhe Kuvendin e Shqipërisë për masat që duhen marrë, të cilat mund të jenë masa ligjore, buxhete financiare, mospërgjegjësia nga ana e administratës, pra janë disa arsye...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo refuzimin, por mospranimin dhe moszbatimin e plotë të tyre e të tjera.

Kolegë, ka disa raste ku rekomandimet e Avokatit të Popullit kanë lidhje me buxhetin ose i njëjti rekomandim përsëritet për të gjitha komisaritet, duket sikur janë 30, 40 apo 49 rekomandime, por në fakt është i njëjti, çka do të thotë se ne mund ta zgjidhim këtë problem, duke adresuar një shqetësim nëpërmjet një rregullimi ligjor ose kërkon buxhetime të caktuara.

Sa i takon pikës 5, në të cilën thuhet: “Avokati i Popullit duhet të krijojë dhe të bëjë publik një regjistër...”

Po e lidh me fillimin: “Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit, që brenda këtij viti, brenda 6 muajve ose 3 muajve, të krijojë dhe të bëjë publik regjistrin e ankesë-kërkesave, si dhe të deklarojë statusin e tyre, duke respektuar rregullat e transperancës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, sepse nuk lejohet të japë të dhëna dhe iniciale e të tjera,

E fundit, avokati duhet të rrisë... Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit të risë angazhimin e tij në ndjekjen e përmbushjes e të tjera, duke fokusuar në mënyrë të veçantë në çështje të tilla, si: buxheti gjinor, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e konsumatorëve dhe të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni lidhur me rezolutat e të tjera.

Për mendimin tim rezoluta duhet rishkruar. Gjuha e përdorur aty, ndoshta e kanë përgatitur me nxitim dhe nuk kanë pasur kohë, sepse rezolutat që bëjnë shërbimet janë shumë të mira, por gjuha e përdorur në këtë rezolutë nuk është gjuha e rezolutave që ne shqyrtojmë në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, gjatë raportimit të Avokates së Popullit, asaj iu lanë shumë detyra për t’u pasqyruar në rezolutë. Në pjesën e parë, e cila fliste për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, ka ngelur vetëm që komisioni t’i bëjë një fletë lavdërimi, ta fusim më xham dhe t’ia japim. Ka një problem, sepse në finale ka bërë 171 rekomandime dhe ky është produkti që ka prodhuar.

Pra, ka marrë 5615 ankesa nga të cilat 2615 janë jashtë sferës së mbulimit që ka Avokati i Popullit dhe ka prodhuar 171 rekomandime, ky është produkti. Në fund të fundit ka punuar 365 ditë të vitit, jo me kapacitet të plotë, sepse plotësimi i stafit të Avokatit me komisionerë është bërë, në mos gabo, në fund të vitit 2018, por 171 rekomandime janë.

Pra, edhe te vlerësimi i veprimtarisë do të duhet të evidentohet kjo pjesë, ndërsa te pjesa e rekomandimeve për vitin 2019, ne atë ditë thamë që pika 6 duhet të kalojë si pika 1, pasi është e papërmbushur si pikë. Pra, në detyrat apo rekomandimet e lëna për Avokatin e Popullit për vitin

2018, pika 6 ishte e papërbushur dhe ne thamë atë ditë që rekomandimet e papërbushura të kalojnë si pikë e parë në rekomandimet e vitit që do të vijë.

Ka dy probleme, zonja Hysi, e para, Avokatja e Popullit është planifikuar për të raportuar në seancën e ditës së enjte.

E dyta, ndërkohë del nevoja e rishikimit të rezolutës nga pikëpamja e shkrimit ligjor, por edhe e gjuhës.

Do t'ia kaloj fjalën kolegut Fino, se e ka kërkuar. Nëse do të ishte e mundur, që duke marrë në konsideratë sugjerimet e zonjës Hysi dhe të zotit Fino, nëse do të ketë, mund ta miratojmë si tekst projektrezolute me sugjerimet dhe vlerësimet që bënë kolegët.

Zoti Fino, fjala për ju.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Më duhet të them që kolegu Shameti duhet të punonte më seriozisht për të bërë një rezolutë, siç kemi bërë edhe rezolutat e tjera....

E kam thënë edhe herë tjetër, rezoluta duhet të jetë me ndërhyrje konkrete. Ajo nuk mund të pasqyrojë ato çka jep ligji, pasi ato janë të përcaktuara në ligj.

Edhe sugjerimi që bëri zonja Hysi, që në çdo fjali thoshte: “Kuvendi kërkon”, mos harro që në krye thuhet” “Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni ta mbaroj, ju lutem!

Duhet ndryshuar gjërat konkrete, me datë konkrete, pjesa tjetër është shumë interesante, kur themi Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit një, dy, tre, katër do të thotë që gjithmonë fjalja fillon “Ne si Kuvend i kërkojmë Avokatit të Popullit...”, pra e kemi vendosur këtë titull. Problemi është që kjo rezolutë do dy-tre rregullime të vogla në sensin e detyrave dhe afateve konkrete, për të cilat, kur ajo të vijë në fund të vitit, mund t'i kërkojmë llogari se çfarë ka bërë për këto gjëra konkrete 6-mujorin e parë.

Pra, unë mendoj se kjo rezolutë është korrekte në mënyrën e formulimit, por ka nevojë për përcaktimin e disa detyrave dhe afateve konkrete, të cilat bëhen më të lexueshme dhe të kuptueshme për vitin e ardhshëm, se kështu siç është formuluar në këtë moment, do të jetë më e vështirë për t'u kuptuar kur të bëhet analiza e rezolutës vitin e ardhshëm për vitin 2019, se çfarë ka realizuar gjatë këtij viti dhe çfarë do të realizojë për vitin pasues. Pra, le të vëmë disa detyra konkrete në këto 5-6 pika.

Besoj se zoti Shameti i ka aftësitë për ta zgjidhur një gjë të tillë, në qoftë se i duhet ndihma jonë, meqë kemi bërë edhe rezoluta të tjera, ne jemi të gatshëm ta ndihmojmë dhe më pas ta miratojmë në parim, për ta kaluar ditën e enjte në seancë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Bie dakord me sugjerimin e zotit Fino.

Në fakt, gjuha e zotit Shameti është pak më e lehtë. Nuk duhet ta ngarkojmë fjalorin tonë duke ndëshkuar Avokatin e Popullit.

Ne ramë dakord që raportimi ishte shumë i mirë, mbi 100 e ca faqe, gjithçka ishte i plotë, pavarësisht ndonjë rregullimi të vogël.

Unë jam dakord ta kalojmë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Shameti, si relator.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

I mirëkuptoj dhe i vlerësoj shumë të gjitha rekomandimet e zonjës Hysi, të cilat do t'i shërbejnë draftit përfundimtar integral, që do t'i çojmë Kuvendit për votim, por në veçanti fjalët e zotit Fino dhe të kolegëve të tjerë.

Jam dakord edhe unë që të gjitha gjetjet dhe vërejtjet vetëm e përmirësojnë gjuhën e rezolutës dhe nuk ia humbasin vlerat vlerësimi të punës dhe veprimtarisë së Avokatit të Popullit, kështu që kërkoj që të gjitha sa u thanë të integrohen në variantin përfundimtar që do t'i çohet Kuvendit për votim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, kolegë!

Jeni dakord ta kalojmë tekstin e projektrezolutës duke reflektuar çështjet e teknikës legislative, por edhe riformulimet përkatëse, që sugjeruan kolegja Hysi dhe zoti Fino? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018”, duke reflektuar pikë për pikë të gjitha sugjerimet dhe propozimet konkrete që bënë kolegët Hysi dhe Fino dhe që u dakordësuan edhe me relatorin.

Ju lutem, zonja Hysi, zoti Shameti, por edhe shërbimet e Kuvendit të merrni në konsideratë sugjerimet përkatëse dhe të riformuloni edhe një herë tekstin e projektrezolutës sipas atyre që ramë dakord.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA